



STEFA BRUNILDA
AUDITUES LIGJOR

Adresa Rr.Perlat Rexhepi
Pll. 9/2/13(Prane Fakultetit Juridik
Tirane, Albania

Phone: (+355 4) 223 234
Mobil : 069 20 57 309
email: bruna.beluli@gmail.com

Tirane me 25 MAR\$ 2018

Drejtuar:

Shoqerise "SORI - AL" sh.p.k.

Lenda: Bashkangjitur Ju paraqes

- **Raportin e llogarive Vjetore per periudhen Janar Dhjetor 2017**
- **Dokumentat Shoqeruese Leter prezantimin, Kontrate, Fature Sherbimi**

SORI – AL sh.p.k.

**Raporti i Audituesit Ligjor
dhe Pasqyrat Financiare më dhe
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

PËRMBAJTJA

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT LIGJOR	3-4
PASQYRAT FINANCIARE:	
BILANCI KONTABËL	5
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	6
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	7
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	8
SHËNIME SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	9 – 25

RAPORTI I AUDITUESIT LIGJOR

Ortakeve dhe Drejtimit të Shoqërisë SORI - AL sh.p.k.

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë tregëtare SORI - AL sh.p.k., të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2017, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale pozicionin financiar të Shoqërisë tregëtare SORI - AL sh.p.k. më 31 dhjetor 2017, performancën financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e mbyllur në atë date, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Përgjegjësia e Audituesit

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar mbi auditimin tonë. Ne kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të përfitojmë siguri të arësyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë pasaktësi materiale. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi për shumat dhe informacionet e

paraqitura në pasqyrat financiare. Proçedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë dhe vlerësimin e rrezikut për pasaktësi materiale në pasqyrat financiare, si rezultat i mashtrimit apo gabimeve. Në bërjen e këtyre vlerësimeve mbi rrezikun, auditori konsideron kontrollin e brendshëm proçedura auditimi të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin dhe përshtatshmërinë e parimeve kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare. Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të arsyeshme për dhënien e opinionit tonë të auditimit.

25 MARS 2018

Tiranë, Shqipëri

AUDITUESI LIGJOR

Brunilda STEFA



SORI - AL sh.p.k.**Bilanci për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Shumat janë të shprehura në LEK)*

<i>Aktivet</i>	Viti 2017	Viti 2016
Aktive Afatshkurtra		
Likujditete dhe vlera te tjera arke	37,899,760.00	46,661,049.00
Kerkesa per arketim nga debitorët	130,408,963.00	62,295,309.00
Kerkesa te tjera te arketueshme	301,823.00	6,041,283.00
Te tjera kerkesa (T.Fitimi)	0.00	0.00
gjendje inventari dhe ne proces	2,901,204.00	3,024,657.00
shpenzime te periudhave te ardhme	2,080,086.00	3,014,606.00
Totali i Aktiveve Afatshkurtra	173,591,836.00	121,036,904.00
Aktivet Afatgjata		
Aktive te qendrueshme te patrupezuara	414,347.00	552,463.00
Aktive te qendrueshme te trupezuara	11,108,398.00	30,093,711.00
Aktive te qendrueshme financiare		
Totali Aktiveve Afatgjata	11,522,745.00	30,646,174.00
Totali i Aktiveve	185,114,581.00	151,683,078.00
Pasivet		
Detyrimet Afatshkurtra		
Hua afatshkurter	10,625,000.00	9,887,546.00
Shuma te arketuara per porosi	0.00	0.00
Furnitore per sherbime	76,987,706.00	68,289,491.00
Personeli	10,125,336.00	9,834,769.00
Hua te tjera	0.00	0.00
Shteti Tatim Taksa	7,505,260.00	6,518,946.00
Totali i Detyrimeve Afatshkurtra	105,243,302.00	94,530,752.00
Detyrimet Afatgjata		
Hua afatgjate	0.00	0.00
Provizione afatgjata		
Totali I Detyrimeve afatgjata	0.00	0.00
Kapitalet e veta		
Kapitali I nenshkruar	35,000,000.00	30,000,000.00
Rezerva ligjore	3,500,000.00	3,000,000.00
Rezerva statutore	0.00	0.00
Rezerva te tjera	4,652,325.00	3,619,481.00
Fitime/Humbje te mbartura	0.00	0.00
Fitime dhe Humbje te ushtrimit	36,718,954.00	20,532,845.00
Totali i Kapitaleve te veta	79,871,279.00	57,152,326.00
Totali i Pasiveve	185,114,581.00	151,683,078.00

Bilanci kontabël duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 9 deri në 25 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

SORI - AL sh.p.k.**Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Shumat janë të shprehura në LEK)*

<i>Te ardhurat</i>	Viti 2017	Viti 2016	Ndryshimi +/-
Nga Veprimtaria			
nga kryerja e sherbimeve	329,455,621.00	280,534,573.00	48,921,048.00
te tjera	1,853,630.00	1,254,763.00	598,867.00
Totali Ardhurave nga veprimtaria	331,309,251.00	281,789,336.00	49,519,915.00
Te ardhura te tjera			
Shtesa e gjendjeve te prodhimit te vet	0.00	0.00	0.00
Shitje I aktiveve te qendrueshme te tjera	13,033,535.00	7,810,638.00	5,222,897.00
	0.00	0.00	0.00
Totali i Ardhurave te tjera	13,033,535.00	7,810,638.00	5,222,897.00
Totali i Ardhurave	344,342,786.00	289,599,974.00	54,742,812.00
Shpenzime te veprimtarise			
Materiale te para+mallra	171,467,287.00	133,112,562.00	38,354,725.00
Personeli	90,060,169.00	88,183,262.00	1,876,907.00
Tatime dhe taksa	1,529,525.00	1,427,236.00	102,289.00
Humbje nga mosarketimi I debitoreve	0.00	0.00	0.00
Shpenzime Transporti	0.00	0.00	0.00
Te tjera	31,759,422.00	33,827,202.00	(2,067,780.00)
Amortizimi I llogaritur	6,307,611.00	8,903,267.00	(2,595,656.00)
Totali i Shpenzimeve	301,124,014.00	265,453,529.00	35,670,485.00
Fitimi nga veprimtaria e shfrytezimit	43,218,772.00	24,146,445.00	19,072,327.00
Te Ardhurat dhe Shpenzime financiare			
Te ardhura dhe shpenzime nga interesat	2,407.00	3,858.00	(1,451.00)
Fitime -humbje nga kembimi	(22,242.00)	7,812.00	(30,054.00)
Te ardhura dhe shp. te tjera financiare	9.00	0.00	9.00
Totali I te Ardhurave dhe Shpenzimeve financiare	(19,826.00)	11,670.00	(31,496.00)
Fitimi Bruto	43,198,946.00	24,158,115.00	19,040,831.00
Shpenzime gjoba e demshperblime	1,000.00	10,350.00	
Humbja / Tatimi fiskale	43,199,946.00	24,168,465.00	
Tatimi mbi Fitimin 15 %	6,479,991.90	3,625,269.75	2,854,722.15
Fitimi Netto	36,718,954.10	20,532,845.25	16,186,108.85

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 9 deri në 25 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

SORI - AL sh.p.k.

Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë të shprehura në LEK)

	Kapitali i nenshkruar	Rezervat	Dividente	Fitimi I Akumuluar	Kapitalet e Veta
Bilanci me 31 Dhjetor 2015	<u>25,000,000</u>	<u>5,413,746</u>	<u>-</u>	<u>11,705,735</u>	<u>42,119,481</u>
Emetimi I aksioneve					-
Fitimi vitit 2016				20,532,845	20,532,845
Humbje e mbartur					-
Dividentet e paguar				(5,500,000)	(5,500,000)
Rritja e rezerves se kapitalit	<u>5,000,000</u>	<u>1,205,735</u>		<u>(6,205,735)</u>	<u>(5,000,000)</u>
Bilanci 31 Dhjetor 2016	<u>30,000,000</u>	<u>6,619,481</u>	<u>-</u>	<u>20,532,845</u>	<u>57,152,326</u>
Emetimi I aksioneve	<u>5,000,000</u>			<u>(5,000,000)</u>	
Fitimi Vitit 2017				36,718,954	36,718,954
Humbje e mbartur					-
Dividente te paguar				(14,000,000)	(14,000,000)
Rritja e rezerves se kapitalit		<u>1,532,844</u>		<u>(1,532,844)</u>	
Bilanci 31 Dhjetor 2017	<u>35,000,000</u>	<u>8,152,325</u>		<u>36,718,955</u>	<u>79,871,280</u>

Shenimet mbi pasqyrat financiare ne faqet vijuese jane pjese perberese e ketyre pasqyrave financiare

Keto pasqyra financiare jane aprovuar nga drejtimi I shoqerise " SORI - AL " sh.p.k. dhe jane firmosur nga

ADMINISTRATORI

Alma TAFANI



Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 9 deri në 25 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

SORI - AL sh.p.k.**Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Shumat janë të shprehura në LEK)*

	Viti 2017	Viti 2016
Aktivitetet Operative		
Fitim / Humbja e vitit	43,198,946.00	24,158,115.00
Amortizimi dhe zhvleresimi (dif konvert)	6,307,611.00	8,903,267.00
(Rritja)/ Ulja e inventareve	123,453.00	961,240.00
(Rritja) / Ulja e kerkesave te arketueshme	(68,113,654.00)	(22,666,792.00)
(Rritja) / Ulja e kerkesave te tjera	5,739,460.00	(5,169,272.00)
(Rritja)/ Ulja e shp. te periudhave te ardhme	934,520.00	(2,562,283.00)
Rritja (Ulja) e detyrimeve	10,712,550.00	(6,352,097.00)
Rritja / (Ulja) e detyrimeve te tjera afatgjata	0.00	0.00
Tatim fitimi I paguar	(6,479,991.90)	(3,625,269.75)
Cash flow nga veprimtaria e shfrytezimit	<u>(7,577,105.90)</u>	<u>(6,353,091.75)</u>
Aktivitetet e Investimeve		
Blerje e aktiveve te qendrueshme te trupezuara	12,815,818.00	5,729,390.00
Shitje e aktiveve te qendrueshme te trupezuara		
Korrigjim I Fondit te Amortizimit		
Fluksi I parase nga Investimet	<u>12,815,818.00</u>	<u>5,729,390.00</u>
Aktivitetet financiare		
Rritja e kapitalit ne para	0.00	0.00
Te Ardhura nga huamarrje afatgjata		
Pagesat e detyrimeve te qerese financiare	0.00	0.00
Pagesa e dividenteve	(14,000,000.00)	(5,500,000.00)
Rritja e rezervave te tjera		
Fluksi I parase nga aktiviteti financiar	<u>(14,000,000.00)</u>	<u>(5,500,000.00)</u>
CASH FLOW (Ulja)	<u>(8,761,287.90)</u>	<u>(6,123,701.75)</u>
Cash dhe Banka ne fillim te periudhes	<u>46,661,049.00</u>	<u>52,784,751.00</u>
Cash dhe Banka ne fund te periudhes	<u>37,899,760.00</u>	<u>46,661,049.00</u>

Pasqyra e rrjedhës së parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 9 deri në 25 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

SORI - AL sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku shprehet ndryshe)

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Shoqëria " SORI – AL " sh.p.k është krijuar si shoqëri me përgjegjesi të kufizuar nga ortakut I vetem Zj. Alma Tafani me Vendim të Gjykatës Tirane Nr.26952 dt.15.01.2002 .Ne vitet e mëpasme me vendim të Gjykatës janë bërë ndryshime në objektin dhe në kapitalin fillestar të shoqërisë.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatëse të Ligjit Nr.9901 dt.14.04.2008 " Per Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare", nga statuti i saj dhe legjislatiioni në fuqi.

Kapitali i nënshkruar dhe i paguar i Shoqërisë më 31 dhjetor 2016 ishte 30,000,000 LEK. Gjatë vitit 2017, kapitali aksionar ka patur ndryshime, është bërë rritja e tij me shumën 5,000,000 LEK, duke arritur kështu në shumën 35,000,000 LEK .Kapitali i Shoqërisë është kapital i regjistruar pranë Qendres Kombëtare të Biznesit. Struktura e kapitalit aksionar më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është detajuar në shënimin 10 të pasqyrave financiare.

Objektivi kryesor i Shoqërisë është tregëtim i ushqimeve për entet shtetërore dhe private, transport mallrash për vete dhe të tregët, realizimin dhe administrimin e shërbimit të lavanterisë, pastrimit kimik për entet publike e private etj.si dhe realizim i shërbimit të pastrimit të ambjentëve të brendshme dhe të jashtme për ente publike dhe private et.

Shoqëria është regjistruar si tatimpagues në Njësinë e Tatimpaguesve të Medhenj me numër identifikimi (NIPT) K 31510059 D. Adresa e saj e regjistruar është rruga « Beqir Luga », TIRANE.Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2017 është 159 punonjës.

2. BAZAT E PËRGATITJES

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK). Bazuar në SKK 11 "Tatim Fitimi", paragrafi 4, Shoqëria ka zgjedhur të mos regjistrojë tatim të shtyrë në pasqyrat e veta financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike. Këto pasqyra financiare janë përgatitur dhe prezantuar në Lek Shqiptar "LEK".

2.3 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtuesit të ushtrjnë gjykimin, vlerësimin dhe supozimet që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe në shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati faktik mund të ndryshojë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacioni mbi fushat më të rëndësishme të pasigurisë së vlerësimeve dhe gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efekt më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë kontabël të veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

3. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare të aplikueshme nga Banka e Shqipërisë për këmbimin e LEK-ut me USD dhe Euro më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
US Dollar (USD)	111,10	128,17
Euro (EUR)	132,95	135,23

3.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre, llogari të arkëtueshme, llogari tregtare të pagueshme dhe llogari të tjera të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to (për instrumentat jo të mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes), përveç siç përshkruhet më poshtë. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset monetare të aktivitetit financiar ose kur Shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë rreziqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat afatshkurtra me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së rrjedhës së parasë, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë depozita të pakushtëzuara me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit. Rakordimi i totalit të mjeteve monetare në arkë dhe në bankë me mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre është paraqitur në shënimin 4.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjoni për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna objektive se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar dhe vonesat në pagesa konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme duhet të zhvlerësohen. Shuma e provigjoni llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël (neto) të aktivitetit dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë në njohjen fillestare dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Vlera e drejtë

Nuk ka politika të rëndësishme kontabël dhe paraqitje të aplikuara nga Shoqëria që të kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për aktivet dhe detyrimet si ato financiare dhe ato jo financiare. Atje ku është e aplikueshme, informacion shtesë në lidhje me supozimet e bëra për përcaktimin e vlerës së drejtë është përfshirë në shënimet shpjeguese të aktivitetit apo detyrimit përkatës. Vlera e drejtë e vlerësuar e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, e kërkesave për t'u arkëtuar dhe e detyrimeve për t'u paguar është e ngjashme me vlerën e tyre kontabël për shkak të maturimit të tyre afatshkurtër.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3.3 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Aktivitet afatgjata materiale maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivitetit. Kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetë të dobishme të ndryshme, ato llogariten si zëra të ndara (pjesë të rëndësishme) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e ndonjë zëri të aktiveve afatgjata materiale janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat e marra nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën kontabël (neto) dhe janë pasqyruar neto në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të aktiveve afatgjata materiale është njohur në vlerën kontabël (neto) të pjesës në qoftë se është e mundur që në të ardhmen të mirat ekonomike të përfshira në atë pjesë do t'i vijnë Shoqërisë dhe kostoja mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve të përditshme të aktiveve afatgjata materiale janë të njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale është llogaritur duke u mbështetur mbi jetën e dobishme të çdo pjese të një zëri duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.

Aktivitet e marra me qira amortizohen me metodën lineare duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit. Toka nuk amortizohet. Të gjitha aktivitet e tjera amortizohen me metodën e vlerës së mbetur.

Metodat e amortizimit, jetët e dobishme dhe vlera e mbetur e pronave, pajsejeve dhe makinerive janë rishikuar në datën e raportimit.



3. POLITIKAT KONTABËL (VAZDHIM)

3.3 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iii. Amortizimi (vazhdim)

Metodat e amortizimit dhe norma e amortizimit për periudhën aktuale dhe atë krahasuese janë si vijon:

Kategoria e aktivit	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Mobilje dhe orendi	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Pajisje zyre dhe informatike	Mbi vlerën kontabël neto	25%
Mjete transporti	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Ndertime	Mbi vlerën kontabël neto	5%

3.4 Zhvlerësimi

i. Aktivet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidencë objektive zhvlerësimi si rezultat i një ose më tepër ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit dhe që kanë patur një ndikim në flukset e ardhshme monetare të vlerësuara të aktivit financiar dhe këto efekte janë të matshme në mënyrë të besueshme.

Një humbje nga zhvlerësimi në lidhje me një aktiv financiar të matur me kosto të amortizuar është llogaritur si diferencë mes vlerës kontabël (neto) dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuara të parasë duke i skontuar me normën origjinale efektive të interesit.

Në veçanti aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të rrezikut kreditor. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Aktivet jo financiare

Vlera kontabël (neto) e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Vlera e rikuperueshme është vlera më e lartë ndërmjet vlerës së drejtë minus koston së shitjes dhe vlerës në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme monetare të pritshme skontojnë në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të aktivit për të cilat parashikimet e flukseve të ardhshme monetare nuk janë rregulluar.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël (neto) e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.5 Provigjonet

Një provigjion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria nuk ka një detyrim aktual ligjor apo konstruktiv i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që të kërkojë flukse dalëse monetare për shlyerjen e tij. Provigjonet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për rreziqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3 POLITIKAT KONTABËL (VAZDHIM)**3.6 Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në përputhje me SKK 8 Të ardhurat. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me arkëtimin e pagesës dhe matjen e kostove përkatëse.

Të ardhurat nga shitja e mallrave njihen kur janë plotësuar të gjitha kushtet e mëposhtme:

- Shoqëria ia ka kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me pronësinë e mallrave;
- Shoqëria nuk vazhdon të jetë e përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në manaxhimin e mallrave në atë masë që tregon se ende zotëron titullin e pronësisë; si dhe nuk ka kontroll efektiv mbi mallrat e shitura;
- Shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri;
- Është e mundur që përfitimet ekonomike që lidhen me transaksionin do të merren nga njësia ekonomike; dhe
- Shpenzimet e bëra ose që do të bëhen në lidhje me transaksionin mund të maten me besueshmëri.

3.7 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat për llogaritë rrjedhëse në bankë dhe fitimet nga kurset e këmbimit. Të ardhurat nga interesat njihen kur realizohen duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë interesat nga huamarrjet dhe humbjet nga kurset e këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes (nëse ka). Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8 Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë periudhës.

4. MJETE MONETARE DHE EKUIVALENTET E TYRE

Mjetet monetare në arkë dhe në bankë më 31 dhjetor 2017 janë si vijon:

	<u>31/12/2017</u>	<u>31/12/2016</u>	<u>Ndryshimi +/-</u>
Para ne dore	30,786,584.00	40,316,796.00	(9,530,212.00)
Para ne Banka	7,113,176.00	6,344,251.00	768,925.00
Totali	<u>37,899,760.00</u>	<u>46,661,047.00</u>	<u>(8,761,287.00)</u>

Mjetet monetare në bankë përfshijnë llogarite rrjedhëse në leke dhe valute me të cilat Shoqëria kryen pagesat si dhe arketon kerkesat nga të tretet

Gjendja e likuiditeteve korrespondon me të dhenat e kontabilitetit rrjedhës në fund të ushtrimit 2017 dhe kjo konfirmohet me nxjerrjet e llogarive të bankave perkatëse si dhe me librin e arkës.

SORI - AL sh.p.k.**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku shprehet ndryshe)***5. LLOGARI TË ARKËTUESHME DHE TË TJERA**

Llogari të arkëtueshme dhe të tjera më 31 dhjetor 2016 përbëhen si vijon:

	<u>31/12/2017</u>	<u>31/12/2016</u>	<u>Ndryshimi +/-</u>
Klientet	130,408,963.00	62,295,309.00	68,113,654.00
Tatim Fitimi/ TVSH	0.00	0.00	0.00
Kerkesa te tjera	301,823.00	6,041,283.00	(5,739,460.00)
Totali	<u>130,710,786.00</u>	<u>68,336,592.00</u>	<u>62,374,194.00</u>

Klientet pasqyrojnë vlerën e akumuluar të faturave që evidentojnë vlerën e shitjeve që shoqëria ka kryer dhe që nuk janë arketuar brenda vitit ushtrimor 2017.

Pasi u bë verifikimi shumat e mesiperme përputhen me tepricën e llogarive perkatese analitike të klienteve në fund të ushtrimit 2017.

• Reparti Ushtarak BUNAVI	5,987,381	leke
• Komanda Doktrines e Stervitjes	12,030,557	leke
• Garda e Republikës	665,909	leke
• Spitali Ushtarak	35,104,488	leke
• Spitali Psikiatrik Vlore	19,104,405	leke
• SU "Shefqet Ndroqi"	6,790,045	leke
• Spitali Rajonal Berat	1,271,723	leke
• Kliente të periudhave të meparshme	1,031,718	leke
• Qendra Formimit Policor	13,762,656	leke
• Arjan Malaj	2,940,000	leke
• Spitali Universitar Obstetrik	1,744,654	leke
• Rep. 752 Fier	293,293	leke
• Drejtoria e Policisë Qarku Fier	925,399	leke
• Delta Force Vlore	329,517	leke
• Rep. Ushtarak 6630	650,583	leke
• Rep.3006 Farke	628,544	leke
• Reparti ushtarak 6640	406,850	leke
• Qendra ek. zhv. dhe edukimit	13,759,682	leke
• Roan Constriction shpk	11,000,000	leke
• Avance shpk	1,581,000	leke
• Qendra Albanologjike Studimeve	144,000	leke
• Albanian International School	102,700	leke

Gjithashtu në rubriken Kerkesa të tjera rezultoi shuma 301,823 LEK e cila përfaqëson kërkesat e shoqërisë për depozita garanzie e parashënime 223,600 LEK, si dhe të drejta për t'u arketuar nga parashënime në shumën 78,223 LEK.

6. INVENTARI

Inventari në fund të periudhës ushtrimore 2017 është 2,901,204 LEK, e cila përfaqëson gjendjen e lendeve të para sipas inventarit fizik të kryer me datë 31 dhjetor 2017.

SORI - AL sh.p.k.**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku shprehet ndryshe)*

	<u>31/12/2017</u>	<u>31/12/2016</u>	<u>Ndryshimi +/-</u>
Lende e pare	2,901,204.00	3,024,657.00	(123,453.00)
Materiale ndihmese	0.00	0.00	0.00
Produkte dhe mallra	0.00	0.00	0.00
Totali	<u>2,901,204.00</u>	<u>3,024,657.00</u>	<u>(123,453.00)</u>

Eshte kryer inventari i mallrave ne magazine me date 31.12.2017, gjate te cilit ne nuk kemi qene prezent, pasi emerimi yne si EKR eshte bere ne nje date te mevonshme, dhe per te cilin nuk kemi verejtje. Dokumentacioni i magazines eshte mbajtur i rregullt.

Mbi bazen e sondazheve qe ne kryem gjykojme se transaksionet ekonomike gjate ushtrimit per blerje jane kontabilizuar ne menyre korrekte sipas Ligjit nr 9228, date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare."

7. PARAPAGIMET DHE SHPENZIMET E SHTYRA

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra rezultojne ne vleren neto 2,080,086 LEK dhe perfaqesojne shpenzimet qe ka bere shoqeria per organizimin e punes dhe qe I perkasin disa periudhave ushtrimore. Gjate vitit ushtrimor 2017 jane kryer investime te reja qe I perkasin periudhave te ardhme ne shumen 280,389 LEK . Ndersa kuota per tu shperndare e ushtrimit 2017 eshte 1,214,909 LEK dhe ka renduar shpenzimet.

8. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE DHE JOMATERIALE

Shoqëria ka një vlerë neto aktivesh të qëndrueshme 11,522,745 LEK. Nga kontrollat me zgjedhje të përdorura rezultoi se në aktiv të bilancit paraqiten të gjitha aktivet për të cilin shoqëria ka titull pronësie, se ato paraqiten të vlerësuara me vlerën e tyre të hyrjes në shoqëri, se ato ekzistojnë realisht, klasifikimi i tyre në elemente të veçanta është bërë në përputhje me rregullat e përcaktuara nga Standartet Kombëtare të Kontabilitetit dhe ligji “Për Kontabilitetin”. Për të gjitha ndryshimet në Aktive të Qëndrueshme ekziston dokumentacioni përkatës. Këto aktive përbehen si më poshtë:

Gjendja e Aktiveve të Qëndrueshme në datë 31.12.2017

	Pajisje inform.	Mjete transporti	Makineri Pajisje	Pajisje zyra	Jomateriale	Totali
<i>Aktive të Trupezuara</i>						
Gjendje 31.12.2016	3,836,789.00	38,098,495.00	13,112,420.00	3,759,345.00	4,138,800.00	62,945,849.00
Shtesa	0.00	0.00	679,657.00	3,750.00	0.00	683,407.00
Pakesime		24,005,496.00	0.00	0.00	0.00	24,005,496.00
Gjendje 31.12.2017	3,836,789.00	14,092,999.00	13,792,077.00	3,763,095.00	4,138,800.00	39,623,760.00
<i>Amortizimi</i>						
Gjendje në 31.12.2016	2,443,004.00	15,888,199.00	7,237,113.00	3,145,022.00	3,586,337.00	32,299,675.00
Shtesa llogaritur	348,447.00	4,442,059.00	1,256,124.00	122,865.00	138,116.00	6,307,611.00
Pakesime		10,506,271.00	0.00	0.00	0.00	10,506,271.00
Gjendje në 31.12.2017	2,791,451.00	9,823,987.00	8,493,237.00	3,267,887.00	3,724,453.00	28,101,015.00
<i>Vlera neto 31.12.2016</i>	1,393,785.00	22,210,296.00	5,875,307.00	614,323.00	552,463.00	30,646,174.00
<i>Vlera neto 31.12.2017</i>	1,045,338.00	4,269,012.00	5,298,840.00	495,208.00	414,347.00	11,522,745.00

Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupezuara është llogaritur sipas normave të nenit 22 të ligjit 8438 datë 28.12.1998, “Për Tatimin mbi të ardhurat”. Llogaritja e amortizimit është bërë për shumën 6,307,611 LEK, kontabilizuar edhe në shpenzime. Sipas llogaritjeve për efektin fiskal shoqëria ka përdorur normat ligjore të amortizimit.

9. TË PAGUESHME TREGTARE DHE TË TJERA

Të pagueshme tregtare dhe të tjera më 31 dhjetor 2017 përbëhen si vijon:

	<u>31/12/2017</u>	<u>31/12/2016</u>	<u>Ndryshimi +/-</u>
Furnitoret	76,987,706.00	68,289,491.00	8,698,215.00
Personeli	10,125,336.00	9,834,769.00	290,567.00
Hua te tjera(ortake)	0.00	0.00	0.00
Shteti tatim taksa	7,505,260.00	6,518,946.00	986,314.00
Huamarrje afatshkurter	10,625,000.00	9,887,546.00	737,454.00
Totali	<u>105,243,302.00</u>	<u>94,530,752.00</u>	<u>9,975,096.00</u>

Të pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 ne shumen 76,987,706 LEK perfaqesojne detyrimet e shoqerise per furnizimet e kryera gjate ushtrimit . Pas verifikimeve te bera rezulton se shumat e mesiperme perputhen me tepricat e llogarive perkatese analitike te furnitoreve ne fund te periudhes ushtrimore 2017 dhe paraqiten si me poshte:

• Anris sh.p.k	410,725	leke
• Geri shpk	62,035,355	leke
• Teuta shpk	233,250	leke
• Aiba Co.	273,600	leke
• Everest IE sh.p.k.	207,969	leke
• AMG shpk	3,258,631	leke
• Agrotek Alb	105,133	leke
• AGS sh.p.k.	3,174,647	leke
• DUA Gaz sh.a.	279,500	leke
• Eraldo sh.p.k.	341,676	leke
• Rapsodia	418,500	leke
• Aleksander Mone	128,910	leke
• Prima shpk	105,608	leke
• Deccop Distribution	157,822	leke
• Haruni sh.p.k.	226,710	leke
• Furnit. per fat. te pamberritura	2,335,195	leke
• Certiquality	310,771	leke
• BBI Group	126,810	leke
• Alma Tafani	476,000	leke
• Lajthiza invest	101,340	leke
• Natalja Kapllanaj	108,752	leke
• HRC shpk	122,880	leke
• Kastrati shpk	269,758	leke
• Aldo-Mandreu	141,375	leke
• Devi 20 shpk	170,100	leke
• Liredi shpk	104,500	leke
• Sigi shpk	158,008	leke
• ASD shpk	101,400	leke
• Edlora imp-exp	212,000	leke

Ne kete ze rezulton edhe shuma 10,625,000 LEK , huamarrja afat shkurter e marre nga shoqeria KPL shpk ne shumen 25,986,487 LEK dhe hua dhene Shoqerise AGS shpk ne shumen 15,361,487 LEK .

SORI - AL sh.p.k.**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku shprehet ndryshe)*

Të pagueshme ndaj shtetit në shumën 7,505,260 LEK përfaqësojnë detyrimet e shoqërisë për tatime e taksa të muajit Dhjetor 2017 dhe perkatesisht përmbajnë detyrimet për sigurimet shoqërore 1,738,802 LEK, tatimin mbi të ardhurat personale 496,806 LEK, tatimi në burim për 138,842 LEK dhe tvsh e pagueshme për shumën 2,620,221 LEK si dhe tatim fitimi për tu paguar në shumën 2,510,589 LEK sipas tabelës së mëposhtme.

	<u>31/12/2017</u>	<u>31/12/2016</u>	<u>Ndryshimi +/-</u>
Shteti TVSH-			
Kreditore	2,620,221.00	3,433,646.00	(813,425.00)
Tatim fitimi	2,510,589.00	953,862.00	1,556,727.00
Sigurime Shoqërore	1,738,802.00	1,835,023.00	(96,221.00)
TAP	496,806.00	210,939.00	285,867.00
Tatim në burim	138,842.00	85,476.00	53,366.00
Totali	<u>7,505,260.00</u>	<u>6,518,946.00</u>	<u>986,314.00</u>

Te gjitha keto shuma perputhen me formularet e deklarimit te tyre .

9. PROVIGJIONE AFATSHKURTRA

Provigjionet afatshkurtra Shoqëria nuk ka krijuar provigjone. .

10. KAPITALI FILLESTAR

Më 31 dhjetor 2017, kapitali fillestar ka vlerën 35,000,000 LEK dhe përbëhet nga 100 pjesë me vlerë nominale 350,000 LEK. Bazuar në ligjin shqiptar për shoqëritë tregtare, 5% e fitimit vjetor, duhet të kalojë çdo vit në rezervë ligjore, deri sa rezerva të arrijë vlerën 10% të kapitalit aksionar. Gjatë periudhës ushtrimore 2017 ka patur ndryshime në kapitalin themeltar është bërë rritja e tij nga 30,000,000 LEK në 35,000,000 LEK, si dhe janë krijuar rezerva nga fitimi i mbartur, rezerve ligjore është rritur me 500,000 LEK duke arritur shumën 3,500,000 LEK dhe rezervat e tjera janë rritur në shumën 1,032,844 LEK duke arritur në shumën 4,652,325 LEK .

Struktura e ortakeve është si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2017		Më 31 dhjetor 2016	
	Në %	Në vlerë	Në %	Në vlerë
Alma Tafani	100%	35,000,000	100%	30,000,000
TOTALI	<u>100%</u>	<u>35,000,000</u>	<u>100%</u>	<u>30,000,000</u>

11. TË ARDHURA NGA SHITJA

Të ardhurat nga shitja për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 përbëhen si vijon:

SORI - AL sh.p.k.**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku shprehet ndryshe)*

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Shitja e neto	329,455,621	280,534,573
Shitja e aktiveve	13,033,535	7,810,638.00
Te tjera	1,853,630	1,254,763.00
TOTALI	344,342,786	289,599,974

12. KOSTO E PRODUKTEVE TË SHITURA

Kosto e produkteve të shitura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 përbëhet si vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Kosto e lendeve te para	-170,252,378	-131,960,192
Kosto e punimeve te blera	-1,214,909	-1,152,370
TOTALI	-171,467,287	-133,112,562

13. KOSTOT E PERSONELIT

Kostot e personelit përbëhen nga pagat dhe shpenzimet për sigurime shoqërore e shëndetësore:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Pagat e personelit	77,705,019	75,866,695
Sigurime shoqërore e shëndetësore	12,355,150	12,316,567
TOTALI	-90,060,169	-88,183,262

14. SHPENZIME TË TJERA

Shpenzime të tjera përbëhet si vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Shpenzime qiraje	-8,296,280	-10,604,533
Shpenzime noteriale, konsulence	-1,639,945	-1,910,108
Shpenzime transport	-3,000	-10,000
Shpenzime per sigurime	-1,166,044	-1,541,905
Mirëmbajtje	-2,786,504	-3,325,331
Shpenzime komunikimi	-657,097	-626,356
Shpenzime bankare	-137,615	-125,130
Tatime e Taksa të tjera	-1,529,525	-1,427,236
Kosto e aktivitet të shitur	-13,499,225	-14,609,962
Shpenzime subvencione ,pritje	-850,250	-248,423
Publicitet reklama	-7,500	0
Trajnim personeli	-60,726	0
Autofaturim	-1,236,963	

SORI - AL sh.p.k.**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku shprehet ndryshe)*

Shpenzime te panjohura	-1,000	-10,350
Shpenzime të tjera	-1,417,273	-815,104
TOTALI	-33,288,947	-35,254,438

15. FITIMI / (HUMBJA) NGA KURSET E KËMBIMIT, NETO

Fitimet / (humbjet) nga kurset e këmbimit janë si vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Fitime të realizuara nga kurset e këmbimit	5,210	27,718
Humbje të realizuara nga kurset e këmbimit	-27,453	-19,906
TOTALI	-22,243	7,812

16. TË TJERA FITIME / (HUMBJE) FINANCIARE, NETO

Të tjera fitime / (humbje) financiare janë si vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga interesi	2,423	3,952
Shpenzime interesi	-7	-94
TOTALI	2,416	3,858

17. TATIM FITIMI

Shoqëria është subjekt i tatim fitimit në Shqipëri, norma e tatim fitimit për vitin 2017 është 15%. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Llogaritja e normës së tatim fitimit efektiv për vitin 2016 dhe 2017 është paraqitur në vijim:

	2017	%	2016	%
Fitimi para tatimit	43,198,946	100%	24,158,115	100%
Tatim fitimi me normën e aplikuar	6,479,842	15%	3,623,717	15%
Shpenzimet e pa zbritshme	150		1,553	
Tatim fitimi	6,479,992		3,625,270	
Parapagime gjatë vitit	3,969,403		2,671,408	
Tatim fitimi i pagueshëm	2,510,589		953,862	

Parapagimet gjatë vitit 2017 përfshijnë efektin e kompesimit të parapagimeve tatimore për periudhën nga janari në dhjetor të 2017 në shumën prej 3,969,403 LEK .

18. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHTËZUARA

Çështje gjyqësore

Më 31 dhjetor 2017 dhe 2016, Shoqëria nuk është përfshirë në procedura ligjore, pretendime dhe çështje gjyqësore me palët e treta. Drejtimi beson se çdo ngjarje e ardhshme e mundshme nuk do të ketë një ndikim material negativ mbi pozicionin financiar, rezultatin e operacioneve apo rrjedhën e parasë së Shoqërisë.

19. PALËT E LIDHURA

Një transaksion me palët e lidhura është një transferim i burimeve, shërbimeve apo detyrimeve midis palëve të lidhura, pavarësisht nëse është caktuar një çmim. Njësitë konsiderohen si të lidhura, nëse njëra palë ose kontrollon palën tjetër, ose ka një influencë të ndjeshme mbi palën tjetër, ose kur kanë kontroll të përbashkët të një njësie tjetër ose kur është anëtar i personelit drejtues të njësisë apo të shoqërisë mëmë të saj (duke përfshirë familjarë të afërt të ndonjërit prej individëve të referuar më sipër). Kontrolli është pushteti për të drejtuar politikatat financiare dhe operacionale të një shoqërie në mënyrë që të marrësh përfitime nga aktiviteti i saj. Kontrolli ekziston kur mëma, direkt ose indirekt, zotëron më shumë se gjysmën e të drejtave të votave, të shoqërisë bijë.

Shoqëria nuk ka kryer transaksione me palët e lidhura ,pasi marredheniet e saj me palët e treta si dhe me ortakët nuk ndodhen në kushtet e paleve të lidhura.

20. NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT

Asnjë ngjarje e rëndësishme nuk ka ndodhur pas dates së miratimit të këtyre pasqyrave financiare për të cilat kerkohet të behen rishikime ose ndryshime. Nga analiza e gjendjes dhe performances financiare të shoqërisë rezulton se në ushtrimin 2017 shoqëria ka stabilitet dhe zhvillim normal të biznesit.

Drejtimi mendon se nuk ka rreziqe të nderprerjes së veprimtarisë së saj për vitin në vazhdim.

21. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

(a) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria të ndeshet me vështirësi në ngritjen e fondeve për të përmbushur angazhimet e lidhura me instrumentat financiarë. Shoqëria monitoron likuiditetet e veta periodikisht në mënyrë që të manaxhojë detyrimet e veta kur ato duhen paguar.

Aktivët financiarë që sjellin interes kanë të bëjnë me llogari rrjedhëse dhe depozita afatshkurtra në banka.

Tabela e likuiditeteve më poshtë është hartuar në bazë të maturimeve kontraktuale të paskontuara të aktiveve dhe detyrimeve financiare.

31 dhjetor 2017	Deri në 1 muaj	1 deri 3 muaj	3 muaj deri 1 vit	1 deri 5 vjet	Maturim i pacaktuar	Totali
Llogaritë e arkëtueshme	0	-	130,408,963	301,823.00	-	130,710,786
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	37,899,760	-	-	-	-	37,899,760
Shpenzime të periudhave të ardhme	-	-	-	2,080,086.00	-	2,080,086
Totali i aktiveve	37,899,760	0	130,408,963	2,381,909	0	170,690,632
Llogaritë e pagueshme	-	-	76,987,706	-	-	76,987,706
Tatim fitimi i pagueshëm	-	2,510,589	-	-	-	2,510,589
Detyrime të tjera afatshkurtra	15,120,007	-	-	-	-	15,120,007
Hua afatshkurtra	-	-	-	10,625,000.00	-	10,625,000
Totali i detyrimeve	15,120,007	2,510,589	76,987,706	10,625,000	0	105,243,302
Ekspozimi neto	22,779,753	-2,510,589	53,421,257	-8,243,091	0	65,447,330

SORI - AL sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku shprehet ndryshe)

21. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

(a) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

31 dhjetor 2016	Deri në 1 muaj	1 deri 3 muaj	3 muaj deri 1 vit	1 deri 5 vjet	Maturim i pacaktuar	Totali	
Llogaritë e arkëtueshme			-	62,295,309	6,041,283.00	-	68,336,592
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	46,661,049		-	-	-	-	46,661,049
Shpenzime te periudhave te ardhme	-		-	3,014,606.00	-	-	3,014,606
Totali i aktiveve	46,661,049	0	62,295,309	9,055,889	0	0	118,012,247
Llogaritë e pagueshme	9,834,769		-	68,289,491	-	-	78,124,260
Tatim fitimi i pagueshëm	-	953,862		-	-	-	953,862
Detyrime të tjera afatshkurtra	5,565,084			-	9,887,546.00	-	15,452,630
Provizjione afatshkurtra	-			-	-		0
Totali i detyrimeve	15,399,853	953,862	68,289,491	9,887,546	0	0	94,530,752
Ekspozimi neto	31,261,196	-953,862	-5,994,182	-831,657	0	0	23,481,495

SORI - AL sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku shprehet ndryshe)

21. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

(b) Rreziku i këmbimit valutor

Rreziku i këmbimit valutor është rreziku që vlera e instrumentave financiare do të luhetet nga ndryshimet në kurset e këmbimit të monedhave të huaja.

Ekspozimi ndaj rrezikut të këmbimit valutor

Ekspozimi neto i Shoqërisë ndaj rrezikut të këmbimit valutor në 31 dhjetor 2017 është si më poshtë:

31 dhjetor 2017	EUR (ekuivalenti ne LEK)	USD (ekuivalenti ne LEK)	LEK	Totali
Llogaritë e arkëtueshme	0		130,710,786	130,710,786
Shpenzime te periudhave te ardhme	-	-	2,080,086	2,080,086
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	314,606	124,542	37,460,612	37,899,760
Totali i aktiveve	314,606	124,542	170,251,484	170,690,632
Llogaritë e pagueshme	0		76,987,706	76,987,706
Tatim fitimi i pagueshëm	-	-	2,510,589	2,510,589
Detyrime të tjera afatshkurtra	-	-	25,745,007	25,745,007
Provizjione afatshkurtra	-	-		0
Totali i detyrimeve	0	0	105,243,302	105,243,302
Ekspozimi neto	314,606	124,542	65,008,182	65,447,330

Ekspozimi neto i Shoqërisë ndaj rrezikut të këmbimit valutor në 31 dhjetor 2016 është si më poshtë:

31 dhjetor 2016	EUR (ekuivalenti ne LEK)	USD (ekuivalenti ne LEK)	LEK	Totali
Llogaritë e arkëtueshme	0		68,336,592	68,336,592
Shpenzime te periudhave te ardhme	-	-	3,014,606	3,014,606
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	30,159	158,242	46,472,648	46,661,049
Totali i aktiveve	30,159	158,242	117,823,846	118,012,247
Llogaritë e pagueshme			78,124,260	78,124,260
Tatim fitimi i pagueshëm	-	-	953,862	953,862
Detyrime të tjera afatshkurtra	-	-	15,452,630	15,452,630
Provizjione afatshkurtra	-	-		0
Totali i detyrimeve	0	0	94,530,752	94,530,752
Ekspozimi neto	30,159	158,242	23,293,094	23,481,495

22. KONTROLLI I RREGULLAVE DHE METODAVE KONTABEL

Jam kujdesur që në plotësimin e posteve të bilancit të llogarise Fitim e Humbje si dhe të Anekseve, të respektohen parimet themelore të kontabilitetit:

- i kujdesit
- i vazhdimësisë së metodave
- i ndarjes dhe i pavarësisë së ushtrimeve
- i kostos historike
- i perhershmerisë së metodave kontabel
- i rëndësisë kuptimore të informacioneve
- i moskompensimit të posteve të bilancit
- i paprekshmerisë së bilancit të çeljes
- i sinqeritetit dhe vertetësisë.

Ne plotësimin e këtyre parimeve nuk ka shmangie.

Tirane më, 25 MARS 2018

AUDITUESI LIGJOR

BRUNILDA STEFA



Handwritten signature of Brunilda Stefa in blue ink. Below the signature is a blue rectangular stamp with the following text: "Brunilda Stefa", "Kontabel i Miratuar", "Shërbort Kontabel", "Tirana - Albania".